

PORTA dhe SHTEGU

Ordinancat dhe besëlidhjet e priftërisë na vendosin në shtegun drejt jetës së përvetshme dhe na bekojnë me forcën që na nevojitet pikërisht tani.

Në të gjithë kërkojmë jetë të përvetshme, që do të thotë të shpëtohem dhe të ekzaltohem në shkallën më të lartë të mbretërisë çelestiale, ku ne mund të jetojmë në praninë e Atit Qiellor si familje.

Përveç besimit në Jezu Krisht dhe pendimit, ordinancat dhe besëlidhjet e priftërisë na lejojnë të hyjmë në shtegun që çon drejt jetës së përvetshme. Pavarësisht se kur hytë në këtë shteg apo se ku jeni në të – qoftë nëse u lindët në Kishë apo u kthyet në besim më vonë, qoftë nëse keni qenë aktiv gjatë gjithë jetës suaj ose porsa po riaktivizoheni në Kishë – ju mund të përparoni përgjatë tij, ndërkohë që përqendrohni te besëlidhjet tuaja dhe tek ajo që mund të bëni për t'i marrë dhe mbajtur ato.

Dhe është e rëndësishme të dini se ordinancat dhe besëlidhjet e priftërisë nuk ofrojnë thjesht premtimin e një të ardhmeje të lavdishme. Ato gjithashtu na japin forcën, ngushëllimin dhe mbështetjen që na nevojitet pikërisht tani, me qëllim që ta ndjekim shtegun dhe që të durojmë deri në fund me drejtësi. ■



"Më e rëndësishmja, është autoriteti i priftërisë në Kishë ai që siguron ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që i lidhin **familjet tok** dhe e kualifikojnë secilin prej nesh që të **kthehet te Perëndia, Ati, dhe te Jezu Krishti** në mbretërinë çelestiale. Këto ordinanca sjellin paqe ngaqë ato janë besëlidhje me Zotin."

Plaku Kuentin L. Kuk, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Paqja Vetjake: Shpërblimi i Drejtësisë", *Liahona*, maj 2013, f. 34.

PAGËZIMI



Sakramenti – ripërtëritja e përjavshme e besëlidhjes së pagëzimit

DHURATA E FRYMËS SË SHENJTË

SHTEGU QË ÇON DREJT JETËS SË PËRVETSHME (DURIMI DERI NË FUND)

Shih 2 Nefi 31.



Porta

ORDINANCA DHE BESËLIDHJE THELBËSORE
RIPËRTËRITJA DHE FORCIMI I ORDINANCEVE

Bekimet patriarkale – udhërrëfim i veçantë individual dhe bekime të premtuara

DHËNIA DHE SHUGURIMI I PRIFTËRISË (PËR TË RINJTË)

INDAUMENTI I TEMPULLIT

Bekime për të sëmuret – ndihmë dhe shërim



Bekime të atit dhe bekime të tjera për ngushëllim dhe këshillim – paqe dhe udhërrëfim kur nevojitet



VULOSJA NË TEMPULL



JETA E PËRVETSHME (MBRETËRIA ÇELESTIALE ME FAMILJET)


NDIHMA PËRGJATË UDHËS

Shkrimet e shenjta – udhërrëfim dhe udhëzim i marrë si pjesë e besëlidhjes midis Perëndisë dhe popullit të Tij (shih DeB 84:57)

Lutja – "[Mësuesi] na ofron besëlidhjen që 'gjithmonë ta kujtojmë Atë' dhe paralajmërimin që të 'lutemi gjithmonë', me qëllim që ne ta vendosim vërtet mbështetjen tonë tek Ai, siguria jonë e vetme" (Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltari i Parë në Presidencën e Parë, "Gjithmonë", *Ensign*, tetor 1999, f. 9).

Shërbimi – përbushja e besëlidhjeve tona duke i shërbyer Perëndisë dhe fëmijëve të Tij, duke përfshirë thirrjet, punën në tempull dhe punën për historinë familjare, ndarjen e ungjillit, shërbimin misionar kohëplotë

Pendimi – të kujtuarit e besëlidhjeve tona dhe afrimi më pranë Shpëtimtarit kur kemi shkuar në udhë të gabuar, nganjëherë duke përfshirë ndihmë nga udhëheqësit e priftërisë



"Të qëndruarit në shtegun e besëlidhjeve, urdhërimeve dhe ordinancave të ungjillit na **mbron** dhe na **përgatit** për të bërë punën e Perëndisë në këtë botë."

Plaku Robert D. Hejls, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Qëndroni të Paepur në Vende të Shenjta", *Liahona*, maj 2013, f. 49.



"Ndërsa mermi pjesë denjësisht në ordinancat e priftërisë, Zoti do t'ju japë **forcë, paqe e këndvështrim të përvetshëm më të sigurt.**"

Plaku Nil L. Andersen, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, "Fuqi në Priftëri", *Liahona*, nëntor 2013, f. 95.

ILUSTRIM NGA BRYAN BEACH